



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
QENDRA KOMBËTARE E INXHINIERISË BIO-MJEKËSORE

Plan -Veprimi

Inventarizimi i Pajisjeve Mjekësore

Tiranë, janar 2014

Përmbajta

Lista e Shkurtimeve	3
Parathënie.....	4
Misioni	4
Qëllimi	4
Situata aktuale.....	4
Institucionet Shëndetësore të përfshira në proces	4
Organizimi, rolet dhe përgjegjësitë	5
MSh.....	5
QKIB	5
Spitalet	6
ISHP.....	6
Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tirane	6
Drejtoritë e Shëndetit Publik/Drejtoritë Rajonale të Shëndetit.....	7
Qendrat Shëndetësore të Përgjithshme dhe të Specialiteteve.....	7
Kalendari i Aktiviteteve.....	8
Aneksi 1- Formulari i regjistrimit të aparaturës mjekësore.....	8
Aneksi 2 – Fleta shoqëruese e formularëve të aparaturave mjekësore.....	8
Aneksi 3 – Udhëzues për plotësimin e formularit të regjistrimit të pajisjes mjekësore	8

Lista e Shkurtimeve

ASHR- Autoriteti Shëndetësor Rajonal

CLINGO- Sistemi i Informacionit për Pajisjet Mjekësore

DRSH- Drejtoria Rajonale Shëndetësore

DSHP- Drejtoria e Shëndetit Publik

ISHP- Instituti i Shëndetit Publik

MSh- Ministria e Shëndetësisë

QKIB- Qendra Kombëtare e Inxhinierisë Bio-Mjekësore

QSh- Qendra Shëndetësore

QSUT- Qendra Spitalore Universitare “Nene Tereza”

Parathënie

Plani i inventarizimit të përgjithshëm të aparaturave mjekësore, përcakton mekanizmat bazë për ndërveprim të të gjithë strukturave pjesëmarrëse në proces. Ekzistojnë përfitime të shumta nga pasja e një inventari të plotë dhe të dixhitalizuar të aparaturave mjekësore në sistemin e inventarizimit të MSH, por ndoshta më e rëndësishmja është një kuptim i plotë i kostos totale të nevojshme për diagnostikimin, trajtimin dhe monitorimin e pacienteve në sistemin shëndetësor.

Misioni

Misioni i këtij plani inventarizimi është që të sigurojë që një aparaturë mjekësore e përdorur në kujdesin shëndetësor është disponibël, e sigurtë, e saktë, e përballueshme dhe me kapacitet të plotë.

Qëllimi

Qëllimi konsiston në përditësimin e plotë të inventarizimit të aparaturave mjekësore në sistemin online të Inventarizimit “Clingo” brenda afatit të përcaktuar. Ky sistem inventarizimi është një platforme e mirëfilltë për planifikim dhe vendimmarrje në institucionet e kujdesit shëndetësor.

Situata aktuale

Qendra Kombëtare e Inxhinierisë Biomjekësore disponon sistemin e informacionit kompjuterik për pajisjet mjekësore CLINGO. Ky sistem është implementuar gjatë vitit 2006-2007 dhe aktualisht në bazën e të dhënave të këtij sistemi janë regjistruar rreth 3490 aparatura mjekësore të disa prej spitaleve kryesore në vend. Për shkak të mos njohjes së rëndësishme së këtij sistemi, të mungesës së njësive të inxhinierisë klinike në disa spitale por edhe për arsye të mungesës së një monitorimi dhe kontrolli në nivel kombëtar, ai nuk është përditësuar në mënyrë të rregullt nga spitalet. Qendra Kombëtare e Inxhinierisë Biomjekësore ka iniciuar punën për fillimin e procesit të inventarizimit të plotë të aparaturave mjekësore. Pas një analize të situatës aktuale, u hartua ky plan veprimi i cili përcakton hapat dhe metodologjinë e nevojshme për realizimin e një inventari kombëtar të aparaturave mjekësore.

Institucionet Shëndetësore të përfshira në proces

1. MSh
2. QKIB
3. ISHP
4. ASHR
5. Spitalet e Bashkiake
6. Spitalet Rajonale
7. Spitalet Terciare
8. DRSH
9. DSHP

10. Qendrat Shëndetësore të përgjithshme
11. Qendrat Shëndetësore të specialiteteve

Organizimi, rolet dhe përgjegjësitë

Në mënyrë që të kemi një qasje sa më efektive lidhur me objektivin final të një informacioni sa më të besueshëm, është i nevojshëm një planifikim i hollësishëm i etapave që duhen ndjekur nga të gjitha institucionet pjesëmarrëse në proces, në mënyrë që të kemi një informacion mbi situatën faktike brenda afateve të përcaktuara nga ky plan-veprimi.

Nisur nga disa problematika specifike dhe shtrirja e gjerë gjeografike e institucioneve të përfshira në proces është menduar që procesi i inventarizimit të ndahet në katër faza:

1. Faza e mbledhjes së të dhënave «Procesi i regjistrimit fizik»
2. Faza e hedhjes së informacionit të mbledhur në sistem
3. Përditësimi i informacionit gjatë prurjeve të reja/nxjerrjeve jashtë përdorimit
4. Faza e kontrollit periodik në vijimësi nga QKIB.

MSH

Ministria e Shëndetësisë do të monitorojë gjithë procesin e inventarizimit të aparaturave mjekësore në të gjithë Shqipërinë. Pas miratimit të këtij plani veprimi me urdhër Ministri, seti i plote i dokumenteve do të publikohet në website-in zyrtar të MSH, nga ku institucionet mund t'i shkarkojnë. MSH në rast se konstaton vonesa dhe parregullsi në realizimin e inventarit nga institucionet shëndetësore, ndërhyrjen menjëherë për zgjidhjen e situatës duke dhënë edhe masat e duhura administrative.

QKIB

Qendra Kombëtare e Inxhinierisë Biomjekësore, do të menaxhojë procesin e inventarizimit të pajisjeve mjekësore në të gjithë Shqipërinë. QKIB ka përgatitur gjithë metodologjinë e nevojshme për mbledhjen dhe hedhjen e të dhënave të inventarit në sistemin e informacionit kompjuterik Clingo.

Pas miratimit me urdhër Ministri të këtij plani veprimi, do të njoftohen të gjithë institucionet shëndetësore dhe njëkohësisht do t'ju kërkohet që të dërgojnë pranë QKIB, inxhinierin klinik/teknikun ose një person tjetër përgjegjës të caktuar nga drejtori i institucionit, për tu trajnuar dhe udhëzuar nga inxhinieret klinik të QKIB lidhur me procesin e inventarizimit. Pas trajnimit QKIB do të shpërndajë tek të gjithë institucionet etiketat me numrat seriale që do t'ju vendosen të gjitha aparaturave mjekësore të cilat do të inventarizohen dhe që nuk janë regjistruar më parë në sistemin Clingo.

Afati përfundimtar për fazën e parë është përcaktuar data 28/03/2014. Brenda kësaj date të gjitha institucionet e përfshira në procesin e inventarizimit kanë detyrim paraqitjen zyrtare të informacionit të regjistruar nëpërmjet formularëve të regjistrimit për çdo pajisje ekzistuese pranë QKIB-së, Tirane.

Pas shqyrtimit të informacionit të mbledhur, QKIB bën vlerësimin e duhur për mundësinë ose jo që disa spitale rajonale apo qendra shëndetësore kanë për të operuar me hedhjen e të dhënave në sistemin e inventarizimit. Në rast se për arsye objektive ky operacion vlerësohet jo efikas atëherë hedhja e të dhënave në sistem do të kryhet nga inxhinieret e QKIB-së.

Sa i përket fazës së tretë dhe të katërt, QKIB në vijim do të përgatisë udhëzues dhe rregullore mbi përdorimin, mirëmbajtjen dhe mënyrën e raportimit të ndryshimeve të ndodhura në gjendjen e inventarit në institucionet shëndetësore publike.

Spitalet

Qendrat Spitalore Universitare në Tiranë, Spitalet Rajonale dhe Spitalet e Bashkiak, duhet të përcaktojnë një individ përgjegjës (inxhinierin klinik/teknikun ose në mungesë të tyre një person tjetër), për të marrë pjesë në trajnimin një ditor që do të zhvillohet në ambientet e QKIB në datën që do të njoftohen. Gjithashtu brenda datës 17.02.2014 këto spitale duhet të ngrijnë grupin e punës për finalizimin e këtij procesi. Udhëzojmë që grupi i punës të ketë në përbërje:

- Nëndrejtorin ekonomik, i cili do të jetë drejtuesi i grupit,
- Inxhinierin klinike/teknikun ose kryeinfermierin
- Magazinierin

Procesi i regjistrimit të të dhënave (plotësimi i formularëve për të gjithë pajisjet) dhe dërgimi zyrtar (se bashku me fletën shoqëruese të formularëve të aparaturave mjekësore të firmosur dhe vulosur) pranë QKIB, duhet të përfundojë brenda datës 28.03.2014. Një kopjet të këtyre formularëve e mban edhe vetë institucioni.

ISHP

ISH, duhet të përcaktojë një individ përgjegjës (pjesë e grupit të punës që do të ngrihet) i cili do të marrë pjesë në trajnimin një ditor që do të zhvillohet në ambientet e QKIB në datën që do të njoftohen. Gjithashtu brenda datës 17.02.2014 ISHP duhet të ngrejë grupin e punës për finalizimin e këtij procesi. Udhëzojmë që grupi i punës të ketë në përbërje:

- Nëndrejtorin ekonomik, i cili do të jetë drejtuesi i grupit,
- inxhinierin klinik/teknikun ose një person tjetër përgjegjës
- Magazinierin

Procesi i regjistrimit të të dhënave (plotësimi i formularëve për të gjithë pajisjet) dhe dërgimi zyrtar (se bashku me fletën shoqëruese të formularëve të aparaturave mjekësore të firmosur dhe vulosur) pranë QKIB, duhet të përfundojë brenda datës 28.03.2014. Një kopjet të këtyre formularëve e mban edhe vetë institucioni

Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tirane

ASHR, duhet të përcaktojë një individ përgjegjës (pjesë e grupit të punës që do të ngrihet) i cili do të marrë pjesë në trajnimin një ditor që do të zhvillohet në ambientet e QKIB në datën që do të njoftohen. Gjithashtu brenda datës 17.02.2014

ASHR duhet të ngrejë grupin e punës për finalizimin e këtij procesi. Udhëzojmë që grupi i punës të ketë në përbërje:

- Nëndrejtorin ekonomik, i cili do të jetë drejtuesi i grupit,
- inxhinierin klinik/teknikun ose një person tjetër përgjegjës
- Magazinierin

Procesi i regjistrimit të të dhënave (plotësimi i formularëve për të gjithë pajisjet) dhe dërgimi zyrtar (se bashku me fletën shoqëruese të formularëve të aparaturave mjekësore të firmosur dhe vulosur) pranë QKIB, duhet të përfundojë brenda datës 28.03.2014. Një kopjet të këtyre formularëve e mban edhe vetë institucioni

Njëkohësisht nëndrejtori ekonomik i ASHR do të koordinojë dhe monitorojë punën për inventarizimin e të gjitha pajisjeve mjekësore në të gjithë qendrat shëndetësore dhe poliklinikat e rrethit të Tiranës.

Drejtoritë e Shëndetit Publik/Drejtoritë Rajonale të Shëndetit

DSHP/DRSH, duhet të përcaktojë një individ përgjegjës (pjesë e grupit të punës që do të ngrihet) i cili do të marrë pjesë në trajnimin një ditor që do të zhvillohet në ambientet e QKIB në datën që do të njoftohen. Gjithashtu brenda datës 17.02.2014 DSHP/DRSH duhet të ngrejë grupin e punës për finalizimin e këtij procesi. Udhëzojmë që grupi i punës të ketë në përbërje:

- Nëndrejtorin ekonomik, i cili do të jetë drejtuesi i grupit,
- inxhinierin klinik/teknikun ose një person tjetër përgjegjës
- Magazinierin

Procesi i regjistrimit të të dhënave (plotësimi i formularëve për të gjithë pajisjet) dhe dërgimi zyrtar (se bashku me fletën shoqëruese të formularëve të aparaturave mjekësore të firmosur dhe vulosur) pranë QKIB, duhet të përfundojë brenda datës 28.03.2014. Një kopjet të këtyre formularëve e mban edhe vetë institucioni

Njëkohësisht nëndrejtori ekonomik i DSHP/DRSH do të koordinojë dhe monitorojë punën për inventarizimin e pajisjeve mjekësore në të gjithë qendrat shëndetësore të rrethit përkatës.

Qendrat Shëndetësore të Përgjithshme dhe të Specialiteteve

Në nivel Qendre Shëndetësore, procesi do të koordinohet dhe monitorohet nga nëndrejtori ekonomik i DRSH-së/DSHP-së të qytetit përkatës dhe në rastin e Tiranës nëndrejtori ekonomik i ASHR-së. Çdo qendër shëndetësore do të ngrejë një grup pune që do të drejtohet nga vete Drejtori i Qendrës dhe të ketë në përbërje ekonomistin dhe një infermier/kryeinfermier. Pas plotësimit fizik të formularëve për çdo pajisje, QSH do të depozitohet në DSHP/DRSH/ASHR përkatëse të gjitha formularët e plotësuar së bashku me fletën shoqëruese të formularëve të aparaturave mjekësore të firmosur dhe vulosur. Sipas rastit DSHP/DRSH/ASHR nga ana saj pasi të mbledhë të gjithë kartelat për të gjithë QSH e rrethit përkatës, i dërgon ato zyrtarisht me shkresë shoqëruese tek QKIB. DSHP/DRSH/ASHR mban kontakt të vazhdueshëm me QKIB

për çdo paqartësi dhe raporton nëse ndonjëra nga QSH apo poliklinikat ka vonesa ose probleme në realizimin e inventarit.

Kalendari i Aktiviteteve

Nr.	Aktiviteti	Institucioni përgjegjëse	Kohëzgjatja	Fillimi	Mbarimi
1	Analiza e situatës aktuale	QKIB	7 ditë	15/01/2014	22/01/2014
2	Krijimi i planit të veprimit	QKIB	7 ditë	23/01/2014	30/01/2014
3	Konsultimi dhe miratimi i planit të veprimit	MSH	12 ditë	31/01/2014	12/02/2014
4	Njoftimi i të gjithë institucioneve	MSh/QKIB	2 ditë	13/02/2014	14/02/2014
5	Trajnimi i personave përgjegjës të institucioneve	QKIB	4 ditë	18/02/2014	20/02/2014
6	Plotësimi i formularëve të pajisjeve dhe dërgimi pranë QKIB	Te gjithë institucionet shëndetësore	40 ditë	20/02/2014	28/03/2014
7	Hedhja e informacionit ne sistemin CLINGO	QKIB/Spitalet Rajonale/Spitalet Universitar	60 ditë	30/03/2014	31/05/2014

Aneksi 1- Formulari i regjistrimit të aparaturës mjekësore
(bashkëlidhur)

Aneksi 2 – Fleta shoqëruese e formularëve të aparaturave mjekësore
(bashkëlidhur)

Aneksi 3 – Udhëzues për plotësimin e formularit të regjistrimit të pajisjes mjekësore
(bashkëlidhur)